

COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #4

Procedurat e farmacive të rrjetit të hapur

Zonë publike

1. Aksesimi në produkte që përzgjidhen vetë nga klientët duhet të kufizohet, për të shmangur që shumë njerëz të kenë kontakte me këto produkte. Ata duhet të aksesohen vetëm nga personeli i farmacisë

Në banak

1. Kur është e mundur, caktoni një punonjës për sportel ose përgjatë hapsirës në banak dhe shmangni shkëmbimet me pacientët/klientët.
2. Mbani në banak vetëm objektet thelbësore.
3. Fshini dhe dezinfektoni banakun pas secilit klient / pacient.
4. Mbani një dezinfektant me bazë alkooli pranë, për të dezinfektuar duart pasi të ndërveproni me secilin pacient / klient.
5. Kur është e mundur, inkurajoni pacientët që të porosisin barnat e tyre përmes faqes në internet të farmacisë (në varësi të juridiksionit) dhe të dorëzohen në shtëpinë e tyre ose vendin e punës.

Distancimi social

1. Kufizoni numrin e pacientëve / klientëve që hyjnë në farmaci në çdo kohë.
2. Vendosni një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër (preferohet më shumë) kur ndërveproni me një pacient.
3. Nëse është e nevojshme, një tabaka mund të përdoret për të mbledhur recetat, dorëzuar barnat dhe për pagesën në mënyrë që të tejkaloni këtë distancë.
4. Këshilloni pacientët të mbajnë një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër midis tyre ndërsa presin, dhe të përdorni shenjat në dysheme për të treguar se ku mund të qëndrojnë;

Gjatë kohës në farmaci

1. Këshilloni pacientët/klientët që të shmangin qëndrimet e gjata në farmaci.
2. Këshilloni pacientët/klientët të shmangin vizitën në farmaci, ata që janë të moshuar ose kanë komorbiditete. Kurdo që të jetë e mundur, pacientë të tillë duhet të kërkojnë nga një anëtar i familjes, një mik apo një fqinj që të shkojë në farmaci në vend të tyre.

Rekomandime për shërbime farmaceutike dhe aktivitete në farmaci

1. Shërbimet mjekësore (matja e presionit të gjakut, kolesterolit, glicemisë), testet e shtatëzënësive, ose administrimi i vaksinave dhe injeksioneve (kudo që është i autorizuar), dhe çdo shërbim tjetër që kërkon kontakt të drejtpërdrejtë me një pacient duhet të ndjekë masa shtesë mbrojtëse, siç është përdorimi i një maske dhe dorezave.
2. Shërbimet e përmendura në pikën e mëparshme mund të kenë nevojë të kufizohen ose ndërpriten nëse ato mund të paraqesin një rrezik për shëndetin e stafit (p.sh., për pacientët me simptoma të COVID-19).

Rekomandime për ekipin e farmacistëve

1. Për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve në farmaci, rekomandohet që ta ndani ekipin në ndërrime turnesh sa herë që të jetë e mundur (për shembull, një në mëngjes dhe një pasdite), me mbylljen e mundshme të farmacisë midis këtyre turneve, për të dezinfektuar të gjithë farmacinë, duke siguruar që anëtarët e secilit turn nuk kanë përplasje.
2. Punonjësit me sëmundje që komprometojnë sistemin e tyre imunitar duhet të përdorin maska dhe mundësisht të kryejnë detyra në pjesën e prapme të farmacisë. Masat e higjienës së duarve duhet të përforcohen.
3. Punonjësit duhet të ndryshojnë rrobat më shpesh.
4. Duhet të shmangët veshja e aksesorëve si rrathë, orë dhe unaza.
5. Kurdo që është e nevojshme të vishni maskë dhe / ose syze, higjiena dhe dezinfektimi i duarve duhet të kryhet para dhe pas.

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

